



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:045313

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05441325

**P.nr.27/2023**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Sadri Krasniqi, me zyrtaren ligjore Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të akuzuarit, N.K. nga ....., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbrojnë av. Selmon Sadiku, për shkak të veprës penale: Kanosja nga neni 181 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.283/2023 të datës 24.02.2023, në prezencën e palëve më datën 29.02.2024, publikisht komunikoi, ndërsa më datën 12.03.2024 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

**N.K.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati A. dhe e ëma K. e lindur L., i lindur më datë ....., ”, me nr. personal ..... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, i pa punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për veprë tjetër penale dhe nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

Në bazë të nenit 363, parag. 1 nën parag. 1.3 të KPPRK-së

### **LIROHET NGA AKUZA**

Sepse:

Me datë 08.02.2023, rreth orës 13:50, në Kamenicë, i pandehuri, me fjalë, e ka kanosur seriozisht të dëmtuarin A. D., person zyrtar, në lidhje me punën e tij, në atë mënyrë që: ka shkuar në zyrën e drejtorit të arsimit, për tu sqaruar se pse i njëjti e kishte larguar nga lista e pagave dhe se gjatë bisedës, e ka ofenduar dhe e ka kanosur duke i thënë: „, ti je idiot, je i pa

fytyrë, ja unë ja ti'' dhe duke ia hedhur çantën dhe disa letra në tokë, që i dëmtuari i kishte në tavolinë, me ç'rast, kanë ndërhyrë disa punëtorë dhe e kanë larguar të pandehurin nga zyra e drejtorit, me çka i pandehuri me veprimet e tij, të dëmtuarit i ka shkaktuar frikë dhe ankth ;

- Me çka *kishte* për të kryer veprën penale, kanosja, nga neni 181 paragrafi 3, lidhër me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pala e dëmtuar A.D. nga ....., nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Në bazë të nenit 453, paragrafi 1, lidhur me nenin 449 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore nga Gjilani, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.283/2023 e datës 24.02.2023, ka propozuar që kundër të akuzuarit N.K. nga ..... të fillohet dhe shtjellohet procedura penale për shkak të veprës penale: kanosja, nga neni 181 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe me rastin e vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për datën 04.10.2023, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shtetit, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën por nuk e pranon fajësinë.

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë, gjykata e ka njoftuar të njëjtin me të drejtat konform nenit 241, paragrafi 7, nën paragrafi 7.1, 7.2 të KPPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit N. K., av.Selmon Sadiku, brenda afatit ligjor, datën 12.10.2023 ka paraqitur kërkesë për hedhjen e aktakuzës, ndërsa kjo gjykatë me Aktvendimin, P.nr.27/2023 të datës 14.11.2023, ka refuzuar kërkesat për hedhjen e aktakuzës.

Gjykata lidhur me rastin ka mbajtur seancë gjyqësore më datën 27.02.2024, në të cilën seancë, pas administrimit të provave të propozuar si në aktin akuzues, si dhe provave të tjera të propozuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, si të atyre personale, po ashtu edhe provave materiale,

Prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri fjalën përfundimtare e paraqiti në formë të shkruar, e të cilën shkurtimisht e elaboroj edhe gojarisht, me ç'rast deklaroj se pas shtjellimit dhe administrimit të gjitha provave, si ato materiale dhe ato personale, u vërtetua bindshëm se i pandehuri, N.K., ka kryer verën penale, kanosja, nga nen 181 paragrafi 3 lidhur me parag. 1 të KPRK-së, ashtu si që është përshkruar ne dispozitiv të aktakuzës. Dyshimi i bazuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale, vërtetohet edhe me dëshminë e dëshmitarëve, Xh.R. dhe Xh. B., e sidomos duke u bazua në deklaratën e dëshmitarit Xh.B., i cili, si në deklaratën e dhënë në polici dhe në Gjykatë, e ka përshkruar rastin ashtu si është përshkruar në aktakuzë dhe se ka deklaruar se është e vërtetë se i pandehuri, me datë 08.02.2023, kishte shkuar në zyrën e të dëmtuarit, në vendin e tij të punës, dhe për arsye se i njëjti, e kishte larguar nga lista e pagave, për disa muaj të pandehurin , për mosbindje të urdhrave për kryerje te punëve, i pandehuri, në prezencën e zyrtarve komunal, i mllefosur, e kanosur, me fjalët," ja ti ja unë", i cili duke e ndier veten të kanosur, e ka lajmëruar rastin ne polici. E po ashtu dyshimi i bazuar, vërtetohet edhe duke u bazua në provën materiale CD- ja me video- inqizim. I pandehuri e ka mohuar pranimin e fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, mirëpo këtë e ka bërë vetëm për ti ikur përligjëses penale, edhe pse të gjitha provat dhe faktet e vërtetojnë të kundërtën. Andaj nga të lartcekurat i propozon gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj me dënim meritior sipas ligjit, në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.K., av.Selmon Sadiku, me rastin e paraqitjes së fjalës përfundimtare deklaroi se me të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arrit përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari N. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Pra me të gjitha dëshmitë, posaçërisht nga dëshmia e të dëmtuarit, u vërtetua se nuk plotësohen elementet esenciale të figurës së veprës penale të kanosjes. Pra i dëmtuari në dëshminë e tij thotë “ nuk ndjehem as i kërcënuar, as nuk ndjej ndonjë obligim që i njëjti do të ketë ndaj meje, dhe kërkojë që përfundimisht të përfundojë pjesëmarrja ime në këto seanca gjyqësore, pasi që konsideroj se nuk ka ndonjë çështje kontestuese lidhur me këtë çështje”. Pra në këtë rast shihet se nuk plotësohet as elementi, se kërcënimimi ka qenë serioz dhe as pala e dëmtuar nuk ka qenë e frikësuar, andaj me vet faktin se edhe në dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë u vërtetua se në rastin konkret ka pasur një shfaqje të pakënaqësisë të një padrejtësi që i është bërë palës nga ana e drejtorisë përkatëse dhe faktin se është kryer kjo padrejtësi e ka vërtetuar edhe Vendimi i komisionit për ankesa, me të cilin Vendim është anuluar vendimi për ndërprerjen e pagës dhe të akuzuarit ia janë kompensuar të gjitha pagat e ndaluara. Po ashtu edhe dëshmitari Xh.R. thotë të mos ketë dëgjuar asgjë kërcënuese edhe pse ka qenë afër tyre.

Atëherë ne mendon se gjykata duke u bazuar në nenin 363 par.1 nën par.1.3 të KPPRK-së, të merr aktgjykim lirues për të akuzuarin, pasi që me asnjë nga provat e administruara nuk u vërtetua që i akuzuari të ketë kryer këtë vepër penale.

I akuzuari N. K. në fjalën përfundimtare deklaroi se, e përkrahi në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit të tij, nuk e ndjen veten fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet nga ana e prokurorisë së shtetit, andaj kërkon nga gjykata që të lirohet nga akuza lidhur me këtë vepër penale sepse të njëjtën nuk e ka kryer.

Gjykata duke pasur parasysh se i akuzuari N. K., nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës, e me qëllim të vërtetimi dhe konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjatë shqyrtimit gjyqësor bëri administrimin e të gjitha provave të propozuara nga ana e prokurorisë së shtetit sipas aktit akuzues, si ato personale, ashtu edhe ato materiale, edhe atë: ka dëgjuar të dëmtuarin në cilësinë e dëshmitarit A. D., dëshmitarët, Xh. R., Xh. B. dhe paraqitjen e mbrojtjes nga i akuzuari N.K., si dhe provat materiale si në shkresat e lëndës.

Nga deklarata e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit **A. D.**, Drejtor Komunal i Drejtorisë së Arsimit, gjykata vërtetoi faktin se gjatë vitit 2022, si Drejtor i Arsimit në Komunën e Kamenicës, për veç detyrave të tjera, i njëjti kishte për obligim edhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Për veç stafit tjetër të punëtorëve arsimor, në listën e pagave ishin edhe 140 persona, të cilët ishin të kualifikuar si punëtor teknik, mirëmbajtës të objekteve dhe mirëmbajtës të nxemjeve. Në shkollat ku mbahej mësimi, kishte rrezik për mbylljen dhe ndërprerjen e procesit mësimor për shkak të pa pastërtisë, andaj ka kërkuar nga disa punëtor të tjerë, në këtë rast edhe prej z.K.i, që të shkojnë në shkollë me punuar, mirëpo në takimin e fundit që kishte me te, i njëjti i ka thënë se “nuk kam llogari”, sepse ishte duke jetuar me familje në Gjilan, dhe shpenzimet e rrugës Gjilan-Kamenicë mund të kishin kosto më të lartë se sa paga që do ta merrte duke punuar, kjo ka qenë në tetor të vitit 2022. Pasi që i njëjti nuk shprehi asnjë vullnet për tu kthyer në punë, e bëri të obligueshëm që të marr vendim për ndërprerjen e pagës. Rrjedhimisht për muajin tetor, nëntor, dhjetor, janar dhe shkurt, i njëjti nuk ka marrë pagë, ndërsa në muajin shkurt 2023 vjen dhe ia kërkon pagën si dhe arsyen se përse ia kanë ndalë pagën, duke e akuzuar për ndikime politike me fjalët “më njeh, nuk më njeh”. Përkundër reagimit të tij emocional, nga i njëjti ka kërkuar që të shkojë në punë dhe është shumë i sigurt se i ka thënë “pa shkuar në punë, pagë nuk ka”. I dëmtuari deklaroi se kur i njëjti e vërejti se unë nuk po shprehi gatishmëri me paguar pa shkuar në punë, i njëjti reagoi, duke i thënë me fjalët “ja ti ja unë”, andaj thekson se në atë moment e ka ndjerë veten të rrezikuar, dhe duke mos e

ditur deri ku do të shkojë ky reagim i tij, e ka ftuar policinë. I dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit në vazhdim deklaroi se pas këtij momenti ka ndodhur që me të njëjtin janë takuar disa herë, por i njëjti ka treguar respekt ndaj meje, prandaj konsideron se kjo ka mundur të jetë një sjellje e momentit që e ka nxjerrë nga vetja, tani me të njëjtin kanë raporte normale dhe nuk kanë kurrfarë problemi, i cili ka filluar të punojë dhe merr pagë. Dëshmitari po ashtu deklaroi se në vendin e punës ku është tani duke punuar -Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit, shpesh i ka ndodh që të has në njerëz të cilët për shkak të shqetësimeve që kanë nga jeta e përditshme e tyre, të mos e kenë edhe sjelljen e duhur para zyrtarit, mësuesit – kolegut, i mirëkupton dhe gjithë herë është munduar që ti qetësoj dhe ti mbaj në nivelin profesional. Andaj thekson se “nuk ndjehem as i kërcënuar, as nuk ndjej ndonjë obligim që i njëjti do të ketë ndaj meje dhe kërkoj që personalisht të përfundojë pjesëmarrjen time në këto seanca gjyqësore, pasi që konsideroj se nuk ka ndonjë çështje kontestuese lidhur me këtë çështje, duke qenë se punëtori-Naseri, tani është duke e mbajtur me rregull orarin e punës dhe i kryen detyrat e veta, më bënë të ndjehem mirë, ngase edhe një shkollë po funksionon dhe është në funksion të qëllimit për çka dedikohet objekti, dhe se tani N. K., është duke e kryer punën ashtu siç duhet, njashtu as drejtori i shkollës ku punon N. nuk ka vërejtje për punën e tij.

Nga deklarata e dëshmitarit **Xh. R.**, zyrtar në Drejtorinë e Arsimit, gjykata vërtetoi faktin se ditën kritike N., tani i akuzuari fillimisht ka zhvilluar një bisedë me drejtorin e arsimit në zyrën e tij, pastaj drejtori si dhe N. kanë dal nga zyra e drejtorit, janë hyrë në zyrën qendrore ku janë punëtorët e tjerë të drejtorisë së arsimit, drejtori A. është ulur te kompjuteri i tij, ndërsa N. vërehej se ishte i nervozuar dhe qëndronte në këmbë në zyre. Në mes tyre vëreheshin disa polemika dhe me sa më kujtohet, sepse ka kaluar një kohë e gjatë nga ai moment, e ka dëgjuar N. duke thënë se “vendimi duhet të vlejë për të gjithë, edhe për punëtorë tjerë të cilët e kanë statusin si unë nëpër shkolla tjera”, zakonisht kjo ishte nëpër shkolla tjera të malësisë, të cilat për shkak të reformave në arsim ishin mbyllur shkollat. Dëshmitari thekson se nuk i kujtohet se N. e ka fyer drejtorin, por e din që i ka thënë se “kjo ka motiv politik, sepse unë jam LDK dhe vetëm mua po më largon nga paga, ndërsa ligji ka me vlejë për të gjithë dhe jo vetëm për mua”, dhe nuk e ka dëgjuar se N. i ka thënë drejtorit “ja ti ja unë”, sepse biseda në mes tyre më tepër ka rrjedh në kontestin se “ligji vlen për të gjithë njëjtë dhe jo vetëm për mua”.

Nga deklarata e dëshmitarit **Xh.B.**, gjykata vërtetoi faktin se muajin shkurt të vitit të kaluar, ka ardhur punëtorin N.K., në zyrën e drejtorit, kanë biseduar diçka në zyre, me një ton më të ngritur se zakonisht që bisedohet në bisedat zyrtare, kjo bisedë ka zgjatur përafërsisht 4-5 min. Pas bisedës që e kanë pasur në zyre, drejtori ka dal në zyrën e personelit, sepse i njëjti

edhe aty e ka një tavolinë pune dhe kompjuterin. Kuptimin e bisedës që kanë zhvilluar drejtori me N.në zyrën e tij nuk e dinë sepse nuk është dëgjuar biseda e tyre dhe nuk e din se çka kanë biseduar, ndërsa kur kanë kaluar në zyrën e personelit, N. ka kërkuar sqarim nga drejtori, duke menduar se vetëm atij i është ndalur paga, duke u arsyetuar se vet është i sëmurë, nënën e ka të sëmurë, jeton me asistencë sociale. Dëshmitari thekson se nuk i kujtohet se N. ka përdorur fjalë fyese ndaj drejtorit, e po ashtu nuk i kujtohet se i ka thënë fjalën “ja ti ja unë”. Por në ballafaqim me deklaratën e dhënë në polici, dëshmitari deklaroi se, nëse ashtu ka deklaruar në polici, atëherë ajo deklaratë është më e freskët dhe sigurisht ajo deklaratë është e vërtetë. Dëshmitari po ashtu deklaroi, ai mendon se N., fjalët “ja ti ja unë”, nuk i ka përdorur për ndonjë kërcënim ndaj drejtorit, por fjala ka qenë më tepër për pagën që i ishte ndalë, sepse i njëjti nuk është larguar nga regjistri i pagave, por është kthyer në gjendjen 0. Andaj thekson sipas ankesës që ka bërë N.në Komisionin e Ankesave, të njëjtit i janë kthyer pagat. Dëshmitari mendon se e gjithë kjo ka ndodhë si pasojë e reformave që janë bërë në arsim në komunën e Kamenicës, ku si pasojë e këtyre reformave ka ardhur deri te çrregullimi i marrëdhënies së punës, ku kishin ngelur 60 punëtor teknik të shkollave pa u sistemuar në vendet e punës, të cilët qëndrojnë në vazhdimësi nën presionin e humbjes së vendit të punës. Sikurse edhe N. K., tani i akuzuari, i cili vendin e punës e ka pasur në shkollën ....., e cila shkollë për shkak të reformave është mbyllur dhe vendi i tij i punës në atë shkollë ishte mbyllur dhe normalisht i njëjti është frikësuar se do ta humb vendin e punës, si dhe faktin se të gjithë punëtorët e stafit teknik në Komunën e Kamenicës, janë me kontratë pune një vjeçare dhe të njëjtit gjithnjë qëndrojnë nën presion, se çka do të ndodh me fatin e tyre në vitin e ardhshëm.

I akuzuari **N.K.** me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së tij deklaroi, ditën kritike është shkuar te drejtori në zyrën e tij, jo për ta kërcënuar, sepse të njëjtin nuk e ka njohur më parë, por është shkuar për të biseduar lidhur me çështjen e pagës që i ishte ndalur. Në zyrën e tij kanë biseduar përafërsisht nja 2 min, pastaj janë dal në zyrën e personelit, ku janë edhe punëtorët e tjerë të arsimit. Është e vërtetë se ditën kritike ishte i mllëfosur, lidhur me ndërprerjen e pagës, sepse ka menduar, ku ende mendon se vetëm atij i është bërë padrejtësi, e po ashtu është e vërtetë se ditën kritike i ka thënë drejtorit, “ja unë ja ti”, kemi me fituar në kontest me ndërprerjen e pagës, ku edhe në polici ka deklaruar se i ka thënë drejtorit se, “ja unë ja ti, kemi me dal prej punës për këtë padrejtësi që ma keni bërë”, çka sipas tij kjo nuk është fjali kërcënuese. Andaj deklaroi se nëse atë ditë e ka fyer drejtorin me ndonjë fjalë fyese, i kërkon falje publike, por nuk është e vërtetë se të njëjtin e ka kërcënuar, por ka qenë i revoltuar, e sidomos është revoltuar në momentin kur e ka pyetur drejtorin “drejtor përse ma keni ndërpre pagën”, i njëjti i ka thënë se “unë jam drejtor këtu”, e kur e ka pyetur se “përse veç mua”, i

njëjti i ka thënë se “i vije radha edhe të tjerëve”. Pastaj është dalë në qytet, dhe në ndërkohë policia e kanë ftuar për të dhënë deklaratë. I akuzuari po ashtu deklaroi se pas asaj dite me drejtorin janë takuar edhe disa herë tjera dhe nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje, është i kënaqur me sistemin e tij në vendin e punës, andaj edhe njëherë e thekson se fjalët që ka përdorur atë ditë ndaj drejtorit nuk kanë qenë fjalë kërcënuese ndaj tij, për ndonjë kërcënim fizik.

Gjykata me kujdes të veçantë vlerësoi mbrojtjen e paraqitur nga i akuzuari N.K. dhe fjalën përfundimtare të paraqitur nga mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. Selmon Sadiku, të cilat si të tilla në tërësi i përfilli dhe i'a fali besimin, sepse të njëjtat sa i përket rrëfimit lidhur me rastin, ishin të qarta, mjaft bindëse, në përputhshmëri dhe në pajtueshmëri të plotë në mes vete, dhe pjesërisht edhe me deklaratën e dëshmitarit Xh.R., i cili pos tjerash thekson se nuk e ka dëgjuar N. se i ka thënë drejtorit “ja ti ja unë”, sepse biseda në mes tyre më tepër ka rrjedh në kontestin se “ligji vlen për të gjithë njëjtë dhe jo vetëm për mua”. E po ashtu edhe me deklaratën e dëshmitarit Xh.B., i cili mendon se N., fjalët “ja ti ja unë”, nuk i ka përdorur për ndonjë kërcënim ndaj drejtorit, por fjala ka qenë më tepër për pagën që i ishte ndalë.

Gjykata me kujdes të veçantë vlerësoi deklaratën e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit A. D., por të njëjtës pjesërisht nuk ka mundur t'ia fali besimin, nga se e njëjta si të tillë ishte e pa kuart dhe jo bindëse, jo e argumentuar mirë, në kundërshtim me vetveten. Themi se ishte në kundërshtim me vetveten për faktin se i njëjti në fillim të deklaratës së tij deklaroi, se “kur i njëjti e vërejti se unë nuk po shprehi gatishmëri me paguar pa shkuar në punë, i njëjti reagoi, duke i thënë “ja ti ja unë”. Andaj thekson se në atë moment e ka ndjerë veten të rrezikuar, ndërsa duke mos e ditur deri ku do të shkojë ky reagim i tij, e ka ftuar policinë”. Ndërsa në përfundim të deklaratës së tij i njëjti deklaroi se “në vendin e punës ku është tani duke punuar si Drejtor i drejtorisë komunale të arsimit, shpesh i ka ndodh që të has në njerëz të cilët për shkak të shqetësimeve që kanë nga jeta e përditshme e tyre, të mos e kenë edhe sjelljen e duhur para zyrtarit, mësuesit, kolegut, i mirëkupton dhe gjithë herë është munduar që ti qetësoj dhe ti mbaj në nivelin profesional. Andaj thekson se “nuk ndjehem as i kërcënuar, as nuk ndjej ndonjë obligim që i njëjti do të ketë ndaj meje dhe kërkojë që personalisht të përfundojë pjesëmarrjen time në këto seanca gjyqësore, pasi që konsideroj se nuk ka ndonjë çështje kontestuese lidhur me këtë çështje”.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës si: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit, 2023-CB-017 i datës 08.02.2023, deklarata e të dëmtuarit A.D., deklarata e dëshmitarëve Xh. R.dhe Xh.B., deklarata e të pandehurit N.K., CD, raporti i zyrtarit policor A.S., si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë, e sidomos pas

dëgjimit të CD-së, në të cilën CD-e nuk dëgjohej as edhe një fjalë kërcënuese që N., tani i akuzuari të ketë përdorur ndaj tani të dëmtuarit A., e po ashtu nuk dëgjohej as fjala “ja ti ja unë” , pra gjykata me asnjërinë me këto prova materiale nuk mundi të vërtetoi faktin se i pandehuri N. K. është kryes i kësaj veprë penale, kanosja nga neni 181, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata po ashtu me kujdes të veçantë vlerësoi edhe pretendimin e fjalës përfundimtare të prokurores së shtetit dhe vërtetoi se prokuroria nuk ka arritur të ofroj prova të mjaftueshme me të cilat plotësohet standarti i të provuarit në një procedurë penale.

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-ës, si ato personale, po ashtu edhe ato materiale, në bazë të cilave prova erdhi në përfundim se me këto prova të administruara nuk është vërtetuar se i akuzuari N. K. të ketë kryer veprën penale, Kanosja nga neni 181, paragrafi 3, lidhur me parag. 1 të KPRK-së. Nuk është kontestuese fakti se i akuzuari ditën kritike ka përdorë fjalën “ja ti ja unë”, fakt të cilin nuk e mohon as i akuzuari, por nuk është vërtetuar se i njëjti këtë fjalë e ka përdorur me qëllim që ta kanosi tani të dëmtuarin A.. Ndërsa te vepra penale, kanosja nga neni 181, parag. 1 i KPRK-së, thuhet se :”kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ti shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkakimit ankthit te personi i tillë, dënohet.....” . Pra për ekzistimin e kanosjes duhet që personit të cilit i drejtohet, t’i bëhet e qartë se çfarë e keqe do ta godas, si dhe ai person do t’i shkaktoj të keqen, po ashtu Kanosja duhet të jetë serioze, gjegjësisht të jetë objektivisht e tillë që tek i kanosuni të krijohet bindja se do të realizohet, përkatësisht se vërtet do ta godas ajo e keqe e cila i bëhet me dije, e që nga provat e administruar nuk është vërtetuar që të dëmtuarit me fjalët “ja ti ja unë”, i është bërë e qartë se çfarë e keqe do ta godas, e po ashtu me këto prova, si dhe me vet deklaratën e të dëmtuarit nuk është vërtetuar se tek i dëmtuari me të vërtetë është krijuar bindja se do ta godas ndonjë e keqe apo çfarë e keqe do ta godas të njëjtin. Ndërsa në paragrafin 3 i këtij neni thuhet “ kur vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën apo në pozitën e tij ose ndaj disa personave....” sipas Komentarit të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, “kjo formë e kualifikuar e kësaj veprë penale konsiderohet se kryhet nëse personit zyrtar i drejtohet kanosja se do të dëmtohet, se do të privohet nga jeta, se do ti shkaktohet lëndim i rëndë trupor, se do të rrëmbehet, se do të privohet nga liria, se do të dëmtohet me armë zjarri, eksplozivi apo me ndonjë mjet tjetër të rrezikshëm për ta dëmtuar jetën dhe shëndetin”, e që me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk janë përmbushur elementet e kësaj veprë penale.



Gjykata vlerëson se përgjegjësia penale duhet të provohet, askush nuk mund të shpallet fajtor në bazë të supozimeve pa pasur prova të drejtë për drejta të cilat do ta përshkruanin me saktësi ekzistimin e fakteve përkitazi me kryerjen e veprës penale, prandaj edhe në të drejtën penale vlen parimi “In Dubio Pro Reo”, pra mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtat e tij, në mbështetje të nenit 3, parag.2 të KPPRK-së.

Meqenëse nuk është vërtetuar se i akuzuari N. K. të ketë ka kryer veprën penale, Kanosja nga neni 181, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, gjykata, në kuptim të nenit 363. paragrafi 1, pika 1.3 të KPPRK-së, të akuzuarin e ka liruar nga akuza. Pala e dëmtuar A. D.nga ....., në fjalën hyrëse ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Në bazë të nenit 453, paragrafi 1, lidhur me nenin 449 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate .

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së, palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2023:045313, 12.03.2024**

Gj y q t a r i,

---

Sadri Krasniqi, d.v.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykata Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.